# DËSHMI ARKIVI

**A-453104**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | "M'u duk mizori ndaj Thaçit", ish-hetuesja e Milloshevliçit: Ndihmoi në krijimin e kësaj gjykate kur ishte President |
| ADRESA | `https://a2news.com/rajoni-bota/kosova/politike/mu-duk-mizori-ndaj-thacit-ish-hetuesja-e-milloshevic-i1185306` |
| BURIMI | a2news.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 17:45:28 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 17:37:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `5a87fad39b049595ec5064f0c85d77804760f4f9a9deb1fdbf52f4ce9f749153` |
| TEKSTI | `46d7a623d87ad9751f8765db66da3b496ef229817731fbb99b2093a5dd750331` |
| PAMJA | `a01b0a49629a56365134b9edb21fbf9ee32d2b515a776c630a24e427482fa59d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `cbd641c1c4a3c7895af9e3b0ffb1e8a66c647fd69093be8dfa2bed2ae5944651` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `a0e62f20f1566f1a6ab80e6e4e50c1c4744bc54a84695e6ceb27bc326e386c4d` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/cbd641c1c4a3c7895af9e3b0ffb1e8a66c647fd69093be8dfa2bed2ae5944651`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# "M'u duk mizori ndaj Thaçit", ish-hetuesja e Milloshevičit: Ndihmoi në krijimin e kësaj gjykate kur ishte President

Nga A2 CNN
17 Shtator 2026, 19:37 | Politikë

Nevenka Tromp, ish-anëtare e ekipit hetimor në tribunalin e Hagës për ish-Jugosllavinë, pas vendimit të Hagës ndaj ish-krerëve të UÇK-së, u shpreh se iu duk mizor që gjyqtari përmendi rrethanë lehtësuese ndaj Thaçit faktin që ai bëri gjithçka që mundi kur ishte President për ta krijuar Gjykatën Speciale.

“Unë u trondita nga ajo që e konsiderova mizorinë e gjyqtarit kryesues, Charles Smith, kur ai përmendi tri gjëra që, sipas meje, ilustrojnë thelbin e pyetjes suaj. Si do të lidhet rekordi historik dhe drejtësia tranzicionale pas luftës me faktin se një ish-drejtues i UÇK-së dhe ish-president i Kosovës është dënuar me 25 vjet burg? Kjo, de facto, për një president si Thaçi, i cili tashmë është në të 60-at, nënkupton një dënim të përjetshëm. Dhe përballë kësaj, nuk pati asnjë president të palës serbe, madje asnjë politikan, me përjashtim të Sainoviçit, i cili ishte krahu i djathtë i Milloshevičit kur bëhet fjalë për krimet në Kosovë. Ai u shpall fajtor për krimet dhe rolin e tij politik në to. Dhe e dini çfarë më dukej krejtësisht mizore? Kur po lexoheshin rrethanat lehtësuese që gjykata mori parasysh në përcaktimin e dënimit, gjyqtari kryesues tha se një nga faktorët lehtësues ishte fakti që Presidenti Thaçi, kur ishte president i Kosovës, bëri gjithçka që mundi për krijimin e kësaj gjykate, përballë një rezistence të madhe të brendshme”, tha Tromp në një intervistë për “Rreth e Qark” në A2CNN.

“A mund ta imagjinoni? Një president i një shteti të mëparshëm, ish-presidenti i Kosovës, ndihmon në krijimin e kësaj gjykate dhe më pas akuzohet, gjykohet dhe dënohet me atë që, për shkak të moshës së tij, mund të jetë praktikisht burgim i përjetshëm. Dhe ju e dini, presidentët e tjerë që po e shohin këtë nga shtete ku situata është gjithashtu shumë e brishtë – po flas për Ukrainën dhe Zelenskyn – duhet të shqetësohen për këtë”, shtoi Tromp.

**(A2 Televizion)**

A2 CNN Livestream

TE FUNDIT

"Janë bërë gabime të rënda ligjore", avokatët e Thaçit do të apelojnë vendimin e Hagës: Thirrje për qetësi në Kosovë

“Do të humbasë Evropa, jo Turqia”, Erdogan: BE-ja nuk është më prioritet për Ankaranë

“Haga i dha Vuçiçit armën më të fortë”, Tromp: Gjykata u krijua për të kënaqur Serbinë, dënimi për Thaçin mizori

Haga unifikon Tiranën, krah Prishtinës deklarata e Kuvendit: Nuk rishkruhet historia e një populli

MË TË VIZITUARAT

Nis Europa League, Milan mundet nga benfica në shtëpi, fiton Bayer Leverkusen

Prej 4 ditësh në arrati dhe në kërkim nga policia greke, Alket Rizai dyshohet...

"Është qesharake", Trump kundër Kanadasë: Tarifa më të larta nëse afrohet me ...

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

MUND TE LEXONI GJITHASHTU

Ish-hetuesja e Milloshevicit: Haga nuk u krijua kurrë për të dhënë drejtësi

Kurti takon kreun e PDK pas dënimit të ish-krerëve të UÇK: Vendimi duhet ndryshuar në shkallën e Apelit

Laçi: Duhet dialog me ndërkombëtarët, po vijnë situata të egra

"Vendimi për krerët e UÇK-së u mor nga disa gjyqtarë mafiozë", Nazarko: Nuk është qëndrimi i Perëndimit

Verdikti i Gjykatës Speciale, ekspertja: Problemi erdhi nga Parlamenti i Kosovës

Robelli: Nuk çojnë askund emocionet dhe mallkimet, duhet krijuar ekip i fuqishëm avokatësh për Apelin

## Latest Videos




"Arbitrazhi na dha të drejtë" MIE: Kontrata koncesionare për aeroportin e Vlorës do të anulohet




Deklarata kundër "Hagës" bën bashkë PS-PD, por jo rezoluta për gjenocidin serb




Haga unifikon Tiranën, krah Prishtinës deklarata e Kuvendit: Nuk rishkruhet historia e një populli




“Padrejetësi e madhe”, eksperti: Haga u dha dritë jeshile regjimeve nëpër botë



© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundësuar nga Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.